

---

**AKT THEMELIMI**  
**i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar**  
**“ASYS KLIMA” SH.P.K.**

Sot, me 26.01.2021, une i nenshkruari: Ervin Faja i datelindjes 05.08.1975 i pajisur me karten e identitetit H50805127W, regjistroj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin “ASYS KLIMA” Sh.p.k.,

**Neni 1**

Personi i siperpermendur, me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi, vendosi te krijojë Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin “ ASYS KLIMA” Sh.p.k., me kapital themeltar 100 000 000 Leke.

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen: Njesia Bashkiake nr. 5, Rruga Sulejman Delvina, pallati Melrose, Dyqani nr. 2, kati 1

Ortaku i kesaj shoqerie do te jete Ervin Faja.

Shoqeria “ASYS KLIMA” Sh.p.k., ka te drejte te krijojë filiale brenda dhe jashte Shqiperise, ne menyrat dhe me kohezgjatje ashtu sikunder e konsideron te arsyeshme, dhe me miratimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Kompania gezon statusin e personit juridik.

Aktivitetet e saj do te kryhen sipas dispozitave te ketij akti, statutit dhe legjislacionit aktual. Statuti i kompanise eshte i bashkelidhur ketij akti te themelimit dhe formon nje pjese integrale me te.

**Neni 3**

Veprimtaria e kompanise si nje entitet juridik fillon me miratimin e krijimit te saj nga ana e organeve kompetente te shtetit dhe do te jete e vlefshme per nje periudhe te pacaktuar kohe.

Shoqeria perfundon aktivitetet e veta me vendimarrje unanime nga te gjithe ortaket e saj.

#### **Neni 4**

Objekti i shoqerise : Import-eksport, tregetim me shumice e pakice te mallrave, pajisjeve, pjeseve te nderrimit per kondicioner. Projektim, arredim, montim, servis te pajisjeve te kondicionimit, tregetim me shumice e pakice i artikujve te ndryshem elektroshtepiake dhe te mallrave te tjera objekt i te drejtes tregetare.

#### **Neni 5**

Kapitali fillestar i kompanise do te jete 100 000 000 leke te ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100 000 000 leke per kuote ku:

Ervin Faja zoteron kete kuote me vlere 100 000 000 leke.

Kapitali themelor eshte depozituar nga aksionaret ne emer te shoqerise. Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet, pervec ketij akti themelimi, me normat e vendosura ne Statut, kundrejt nenshkrimet te ortakeve, dhe aprovimit nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, diten qe do te marre cilesine e personit juridik.

#### **Neni 6**

Fitimi neto qe do te realizohet nga aktivitetet e kompanise do te ndahet midis ortakeve ne perpjesetim me aksionet e tyre ne kompani. Çdo anetar eshte i lire per te marre pjesen e vet te fitimeve ne nje llogari bankare brenda apo jashte shtetit Shqiptar.

#### **Neni 7**

Per borxhet qe mund te ezistojne ne te ardhmen ndaj paleve te treta gjate aktivitetit, shoqeria do te pergjigjet vetem me kapitalin e saj themeltar. Anetaret nuk jane pergjegjes per borxhet e shoqerise me pronen e tyre.

#### **Neni 8**

Anetaret jane te detyruar per te ruajtur natyren konfidenciale te aktivitetit te shoqerise.

#### **Neni 9**

Marredheniet e punes ne shoqeri apo degjet e saj rregullohen me kontraten e punes ne lokalitetin e tyre dhe ne menyren e percaktuar nga ana e shteteve perkatese.

#### **Neni 10**

Rregullime me te detajuara mbi organizimin e kesaj shoqerie jane te percaktuara ne Statutin e saj.

Themeluesi pas leximit me kujdes te Aktit te Themelimit e nenshkruan si te sakte dhe ne perputhje me vullnetin e tij.

**Emri dhe nenshkrimi i Ortakut Themelues:**

ERVIN FAJA

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Ervin Faja', written in a cursive style.